

18 Prill , 2024

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Diplomimi është afër ! Dhe ndërsa ne e dimë se maturantët tanë janë duke punuar shumë për të përfunduar studimet e tyre të shkollës së mesme dhe duke u përgatitur për festimin e tyre historik, ne duam gjithashtu të shfrytëzojmë rastin për t'u kujtuar nxënësve të rinj të shkollave të mesme dhe familjeve të tyre se nuk është kurrë herët për të filluar përgatitjen për diplomimin. .

Tani është një mundësi e shkëlqyer për të rishikuar përparimin e fëmijës suaj drejt diplomimit, pavarësisht nga moshja e tyre! [“What Families Can Do” / Fletushka “Çfarë mund të bëjnë familjet”](#) shpjegon disa mënyra të rëndësishme që ju mund të mbështesni rrugën e fëmijës suaj drejt suksesit të diplomimit.

Konkretisht për prindërit e gjimnazistëve:

1. Përdor këtë [Graduation Checklist/ Lista Kontrolluese e Diplomimit](#) për të siguruar që kërkesat janë përbushur dhe/ose janë në rrugën e duhur për t'u përbushur.
2. Rishikoni Udhëzuesin Hap - pas - Hapi për të hyrë në statusin e diplomimit të studentit, i gjetur [këtu](#), për të nxjerrë një raport dhe për të parë detajet akademike të fëmijës suaj.
3. Numëroni kreditet. Nëse vëreni se fëmija juaj është jashtë rrugës së diplomimit , caktoni një konferencë me shkollën e tyre për të diskutuar një plan.
4. Sigurohuni që kurset dhe programi i fëmijës suaj të jenë në përputhje me njërin prej tyre [Pathways to Graduation / Rrugët drejt Diplomimit](#). Rregulloni sipas nevojës me ndihmën e mësuesve dhe këshilltarëve të shkollës.

Është e rëndësishme të mbani mend se ndërsa diplomimi është një moment historik i madh dhe diçka për t'u festuar, është gjithashtu një urë për gjëra më emocionuese si kolegji apo karriera. Muajin e kaluar, ne ndamë më shumë informacion rreth [Career Preparation Programs / Programi i Përgatitjes për Karrierë](#) që Drejtoria ofron për të ndihmuar studentët të përgatiten për jetën pas shkollës së mesme. Ju inkurajoj të mësoni më shumë rreth këtyre programeve dhe më shumë duke vizituar websajtin e [Postsecondary Readiness](#).

Një program që dua të nënvizoj në mënyrë specifike sot, është “Career Connected Learning PHL (C2L-PHL). Kjo iniciativë e fuqisë punëtore është një partneritet midis “ City of Philadelphia Office of Children and Families and Philadelphia Works “, dhe rrit sasinë dhe cilësinë e aktiviteteve mësimore të bazuara në punë për studentët nga i gjithë qyteti, duke zgjeruar mundësitë për të rinjtë e Filadelfias për të arritur suksese në karrierë pas shkolles së mesme. Nëpërmjet C2L-PHL, mijëra të rinj do të kenë akses gjatë gjithë vitit në praktika, projekte të të mësuarit eksperimental, eksplorim dhe mentorim në karrierë, zhvillim profesional dhe mbrojtje në punë.**Aplikacioni tani është i hapur – mund të mësoni më shumë dhe të aplikoni në phila.gov/c2lphl.**

Ne mbetemi partnerët tuaj në suksesin e fëmijës suaj! Faleminderit që na besuat të pregatisim të gjithë studentët për të imagjinuar dhe realizuar çdo të ardhme që dëshirojnë!
Sinqerisht,

Jermaine Dawson, Ed.D.
Zëvendës Mbikëqyrës i Shërbimeve Akademike
Drejtoria Arsimore e Filadelfias